



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

Nr. 4929 prot.

Tiranë, më 31/10 2014

L Ë N D A: Kthim Përgjigjeje

D R E J T U A R: Z. Feruzan Durdaj
Kryetar i Shoqatës së Familjeve të Viktimave të Gërdecit
Rruga "Nikolla Tupe", Pll. 4, Shk. 1, Ap. 5, Tiranë

I nderuar z. Durdaj ,

Në lidhje me letrën që i keni drejtuar më parë Kryeministrit, z. Edi Rama, jeni njoftuar se iu dërgua për ndjekje Ministrisë së Mbrojtjes.

Nga ana e këtij institucioni jemi informuar nëpërmjet shkresës nr.3543/5, datë 17.10.2014, fotokopjen e së cilës do ta gjeni bashkëlidhur.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Me respekt

Drejtor i Marrëdhënieve me Qytetarët

Ana Kaffi



Lidhje

L

Nr 4929
2014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. *3553* / Prot.
5

Tiranë, më *17* / 10 / 2014

Lënda: Mbi ankesën e Shoqatës së Familjarëve të Viktimave të Gërdecit.

Drejtuar: Znj Ana Rafti
Drejtore i Marrëdhënieve me Qytetarët.

E nderuar zonja Rafti,

Në përgjigje të shkresës tuaj nr.prot. 4992-17 datë 16.07.2014 "Dërgohet letra e Shoqatës së Familjeve të Viktimave të Gërdecit" ju informojmë se:

Ankuesi, me cilësinë e përfaqësuesit të Shoqatës së Familjeve të Viktimave të Gërdecit, ka kërkuar dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jo pasuror vlerën prej 1,904,040,617 (një miliard e nëntëqind e katër milion e dyzet mijë e gjashtë qind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

Dëmshpërblimi kërkohet të shlyhet vullnetarisht nga Ministria e Mbrojtjes dhe MEICO të cilat në ankesë cilësohen sipas tyre përgjegjëse për shkaktimin e tragjedisë, duke mos përmendur fare faktin se kjo veprimtari është kryer nga disa shoqëri private dhe se një pjesë e viktimave punonin realisht atje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.381, datë 12.03.2012 lënë në fuqi edhe nga vendimi nr.138, datë 13.02.1013 i Gjykatës së Apelit Tiranë, kanë arritur në përfundimin se vdekja e shkaktuar ndaj këtyre personave ka ardhur si pasojë e shkeljes së rregullave dhe sigurisë në punë.

Theksojmë se, të interesuarit i janë drejtuar disa herë me kërkesë administrative për zgjidhjen e kësaj çështje institucionit të Ministrisë së Mbrojtjes, për të cilat kanë marrë edhe përgjigjet se, institucioni nuk është përgjegjës për shkaktimin e këtij aksidenti dhe se çështja tashmë po ndiqet në rrugë gjyqësore nga vetë të interesuarit.

Kërkesën administrative për dëmshpërblim, kërkuesit e bazojnë tek parashikimet e ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të Administratës shtetërore" (nenet 3, 6 19, dhe 20) dhe Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë të cilët rregullojnë dhe japin mundësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Në nenin 3 "Rastet e përgjegjësisë se organeve shtetërore" parashikohet se:

"Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private në rastet që vijojnë:

- a) kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme;
- b) kur kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, por që sjellin dëmtimin e interesave të ligjshme të personave fizike a juridikë private;

c) kur, megjithëse kryejnë veprime a mosveprime të ligjshme, u shkaktojnë një dëm të pabarabartë subjekteve të cilëve u drejtohet ky veprim a mosveprim”.

Në nenin 6 “Shpërblimi” përcaktohet se:

“Shpërblimi qëndron në pagimin e një sasive të hollash për të baraspeshuar një dëm, i cili nuk mund të ndreqet në mënyrë të drejtpërdrejtë”.

Në nenin 19 përcaktohet se:

“Vendimi i organit të administratës shtetërore për njohjen e përgjegjësisë në shkaktimin e dëmit, për pagimin e dëmshpërblimit përkatës dhe të masës së tij, përbën titull ekzekutiv”.

Në nenin 20 “Dispozitat e fundit” përcaktohet se:

“Të gjitha detyrimet për shkaktimin e dëmit, që organet e administratës shtetërore kanë kundrejt personave fizikë a juridikë privatë, në rast se nuk paguhen menjëherë për pamundësi financiare, futen si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit në vitin pasardhës”.

Sa më sipër parashtroam, të interesuarit kërkojnë zgjidhjen në mënyrë administrative të kësaj kërkesë duke përcaktuar shumën dhe shpërblimin financiar të ndarë sipas trashëgimtarëve.

Theksojmë se në rastin konkret të marrjes së përgjegjësisë dhe të shpërblimit eventual të dëmit, sugjerojmë ngritjen e një grupi me ekspertë të fushave dhe njohurive të ndryshme për përcaktimin e dëmit dhe masën e shpërblimit për këtë rast.

Nga përfaqësuesit e trashëgimtarëve, pjesëmarrës në proceset gjyqësore që zhvillohen në gjykatë është pretenduar se ka një iniciativë të Kryeministrit për zgjidhjen me pajtim të kësaj çështje.

Ju faleminderit.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

ARIAN KRAJA

